Врз основа на член 24 став 1 од Законот за лобирање („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 122/2021), а во врска со членот 60 од Деловникот на Собранието на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 91/2008, 119/2010 и 23/13 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ број 152/19), претседателот на Собранието на Република Северна Македонија, донесе

**ПРАВИЛНИК**
**за остварување, евиденција и идентификување на контакти со цел лобирање при донесувањето на закони и други акти во Собранието на Република Северна Македонија и за обезбедување на транспарентност на процесите**

## I.ОПШТИ ОДРЕДБИ

### Предмет на уредување
### Член 1

(1) Со овој правилник се уредува начинот на остварување на контакти кои имаат цел лобирање во Собранието на Република Северна Македонија (во натамошниот текст: Собранието) при подготвување, разгледување и донесување на закони и други општи акти, евиденцијата на овие контакти; идентификувањето на лицата кои остваруваат контакти со цел лобирање и нивната евиденција, како и евиденција на другите контакти што се остваруваат во Собранието.

(2) Со овој правелник се уредува и објавувањето на соопштенија за остварени официјални средби и состаноци, со податоци за присутните учесници и предметот на дискусија.

## II. ОДРЕДБИ ЗА ЛОБИРАЊЕ

### Лица кај кои се лобира
### Член 2

Во Собранието се лобира кај следниве лица:

- претседателот на Собранието;
- потпретседателите на Собранието;
- пратеници, координатори на пратенички групи и претседатели на комисии;
- генерален секретар на Собранието;

Në bazë të nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit për lobim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 122/2021), e në lidhje me nenin 60 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 91/2008, 119/2010 dhe 23/13 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 152/19), Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

**RREGULLORE**
**për realizimin, evidencën dhe identifikimin e kontakteve me qëllim të lobimit gjatë miratimit të ligjeve dhe akteve të tjera në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për sigurimin e transparencës së proceseve**

## I.DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Lënda e rregullimit
### Neni 1

(1) Me këtë rregullore rregullohet mënyra e realizimit të kontakteve që kanë për qëllim lobimin në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) gjatë përgatitjes, shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme, evidencën e këtyre kontakteve; identifikimin e personave që realizojnë kontakte për qëllime lobimi dhe evidencën e tyre, si dhe evidencën e kontakteve të tjera që realizohen në Kuvend.

(2) Me këtë rregullore rregullohet edhe publikimi i njoftimeve për takimet dhe mbledhjet e realizuara zyrtare, me të dhëna për pjesëmarrësit e pranishëm dhe lëndën e diskutimit.

## II. DISPOZITA PËR LOBIM

### Personat te të cilët lobohet
### Neni 2

Në Kuvend lobohet te personat e mëposhtëm:

- Kryetari i Kuvendit;
- nënkryetarët e Kuvendit;
- deputetët, koordinatorët e grupeve të deputetëve dhe kryetarët e komisioneve;
- sekretari i përgjithshëm i Kuvendit;

- замениците на генералниот секретар на Собранието и

- кабинетски службеници и посебни советници во Собранието.

**Контакт со цел лобирање**
**Член 3**

(1) Контакт со цел лобирање е посредна или непосредна комуникација со лицата кај кои се лобира од членот 2 на овој Правилник, без оглед на локацијата каде таа се остварува, начинот и средството за комуникација кое се користи.

(2) Барање за остварување на контакт со цел лобирање претставува секое усно или писмено барање за состанок или средба, телефонски контакт или контакт преку електронска пошта, насочено кон лицата кај кои се лобира во Собранието.

(3) Лицата кај кои се лобира треба да ја утврдат целта на бараниот контакт, при што по потреба може да побараат повеќе информации за бараниот контакт.

(4) Доколку од лицето кое ги контактира не ги добијат податоците потребни за утврдување на целта на бараниот контакт, лицата кај кои се лобира го прекинуваат натамошниот контакт со тоа лице.

**Податоци и нивна проверка**
**Член 4**

(1) Кога лицата кај кои се лобира ќе утврдат дека контактот е со цел лобирање, пристапуваат кон проверка на лицето кое ги контактира, при што ќе побараат лицето кое ги контактира да достави податоци за идентификација како лобист или претставник на лоби организација, како и податоци за нарачателот на лобирањето.

(2) Доколку лицето кое ги контактира не ги даде или одбие да ги даде податоците потребни за вршење на проверка, односно даде невистинити или нецелосни податоци за вршење на проверка, лицата кај кои се лобира го прекинуваат натамошниот контакт со тоа лице.

(3) Проверката се врши преку споредување на податоците за идентификација, со податоците запишани во Регистарот на лобисти, лоби организации и лобирање на веб -

- zëvendëssekretarët e përgjithshëm të Kuvendit dhe

- nëpunësit e kabinetit dhe këshilltarët e veçantë në Kuvend.

**Kontakti me qëllim të lobimit**
**Neni 3**

(1) Kontakti me qëllim të lobimit është komunikimi i tërthortë ose i drejtpërdrejtë me personat te të cilët lobohet nga neni 2 i kësaj Rregulloreje, pavarësisht nga vendndodhja ku realizohet, mënyra dhe mjeti i komunikimit që përdoret.

(2) Kërkesa për të realizuar kontakt me qëllim të lobimit është çdo kërkesë me gojë ose me shkrim për takim ose mbledhje, kontakt telefoni ose kontakt me postë elektronike, drejtuar personave te të cilët lobohet në Kuvend.

(3) Personat te të cilët lobohet duhet ta përcaktojnë qëllimin e kontaktit të kërkuar, me ç'rast sipas nevojës mund të kërkojnë më shumë informacione për kontaktin e kërkuar.

(4) Nëse nga personi i cili i kontakton nuk i marrin të dhënat e nevojshme për përcaktimin e qëllimit të kontaktit të kërkuar, personat te të cilët lobohet e ndërpresin kontaktin e mëtejshëm me atë person.

**Të dhënat dhe verifikimi i tyre**
**Neni 4**

(1) Kur personat te të cilët lobohet do të përcaktojnë se kontakti është me qëllim të lobimit, i qasen verifikimit të personit që i kontakton, me ç'rast do të kërkojnë personi që i kontakton të dorëzojë të dhëna për identifikimin si lobist ose përfaqësues i organizatës lobuese, si dhe të dhëna për porositësin e lobimit.

(2) Nëse personi që i kontakton nuk i jep ose refuzon t'i japë të dhënat e nevojshme për të kryer verifikimin, përkatësisht jep të dhëna të pavërteta ose të paplota për të kryer verifikimin, personat te të cilët lobohet e ndërpresin kontaktin e mëtejshëm me atë person.

(3) Verifikimi kryhet duke krahasuar të dhënat e identifikimit me të dhënat e regjistruara në Regjistrin e lobistëve, organizatave të lobit dhe lobimit në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

(4) Nëse me verifikimin e kryer konstatohet

страницата на Државната комисија за спречување на корупцијата.

(4) Ако со извршената проверка се утврди дека лицето кое ги контактира е запишано во Регистарот на лобисти, лоби организации и лобирање и има активен статус на лобист / претставник на лоби организација, лицата кај кои се лобира може да договорат остварување на контактот со тоа лице, во определено време и на определено место.

**Остварување на контакти со цел лобирање**
**Член 5**

(1) Контактот за лобирање може да се оствари преку состанок/средба, телефонски повик, како и преку електронски средства (електронска пошта, интернет платформа за состаноци и слично). За остварениот контакт се известува генералниот секретар на Собранието.

(2) При остварувањето на контактот со цел лобирање, лобистот/претставникот на лоби организацијата, треба да даде податоци и информации за предметот на лобирање, усно или во писмена форма, како и да достави материјал кој се однесува на предметот на лобирање.

(3 ) Лицата кај кои се лобира ќе го прекинат контактот и ќе одбијат натамошен контакт со лобистот, лоби организацијата или претставник на лоби организацијата кога ќе утврдат дека постапуваат спротивно на одредбите од Законот за лобирање.

**Евиденција на контакти со цел лобирање**
**Член 6**

(1) Евиденцијата на контактите остварени со цел лобирање во Собранието ја води Секторот за поддршка на генералниот секретар на Собранието во Службата на Собранието.

(2) Евиденцијата на остварените контакти со цел лобирање ја води лице од редот на собраниските службеници, определено од генералниот секретар за таа цел.

(3) Образецот за евиденцијата на контакти со цел лобирање е составен дел од овој правилник. (Образец 1).

se personi që i kontakton është i regjistruar në Regjistrin e lobistëve, organizatave lobuese dhe lobimit dhe ka status aktiv të lobistit/përfaqësuesit të organizatës lobuese, personat te të cilët lobohet mund të dakordojnë realizimin e kontaktit me atë person, në kohë të caktuar dhe në vend të caktuar.

**Realizimi i kontakteve me qëllim të lobimit**
**Neni 5**

(1) Kontakti për lobim mund të realizohet nëpërmjet takimit/mbledhjes, thirrjes telefonike, si dhe nëpërmjet mjeteve elektronike (postës elektronike, platformës së internetit për takime, etj.). Për kontaktin e realizuar njoftohet sekretari i përgjithshëm i Kuvendit.

(2) Gjatë realizimit të kontaktit me qëllim të lobimit, lobisti/përfaqësuesi i organizatës lobuese duhet të japë të dhëna dhe informacione për lëndën e lobimit, me gojë ose me shkrim, si dhe të dorëzojë material që i referohet lëndës së lobimit.

(3 ) Personat te të cilët lobohet do ta ndërpresin kontaktin dhe do të refuzojnë kontakt të mëtejshëm me lobistin, organizatën lobuese ose përfaqësuesin e organizatës lobuese kur do të konstatojnë se veprojnë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lobim.

**Evidencë e kontakteve me qëllim lobimi**
**Neni 6**

(1) Evidencën e kontakteve të realizuara me qëllim të lobimit në Kuvend e mban Sektori për Mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit në Shërbimin e Kuvendit.

(2) Evidencën e kontakteve të realizuara me qëllim të lobimit e mban person nga radhët e nëpunësve të Kuvendit, i caktuar nga sekretari i përgjithshëm për këtë qëllim.

(3) Formulari për evidencën e kontakteve me qëllim të lobimit është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. (Formulari 1).

## III. ДРУГИ КОНТАКТИ

**Идентификување и евиденција на лицата кои остваруваат контакти**

**Член 7**

Покрај контактите остварени со цел лобирање, лицата кои остваруваат контакти во Собранието реба да се идентификуваат и за истите се води евиденција, согласно Правилникот за внатрешен ред во Собранието.

## IV. ТРАНСПАРЕНТНОСТ НА ПРОЦЕСИТЕ

**Подготвување, донесување и изменување закони, подзаконски или други општи акти**

**Член 8**

(1) Подготвувањето на предлозите на закони и други општи акти и на амандманите на предлозите на законите и на другите општи акти го врши Службата на Собранието по барање на пратеник/пратеници или врз основа на расправа од седници на работни тела. Подготвувањето и разгледувањето на предлозите на закони и на другите општи акти се врши согласно Деловникот на Собранието.

(2) Генералниот секретар на Собранието се грижи на транспарентен начин да ги објави податоците за процесите од ставот (1) на овој член.

**Објавување на соопштенија за остварени официјални средби и состаноци**

**Член 9**

(1) Собранието на официјалната веб-страница www.sobranie.mk редовно објавува соопштенија за сите остварени официјални средби и состаноци, без разлика дали средбата/состанокот е со цел лобирање или е со друга цел.

(2) Собраниските службеници од Одделението за информирање на јавноста соопштенијата ги објавуваат веднаш, а најдоцна во рок од три работни дена по одржување на официјалната средба, односно состанок.

## III. KONTAKTE TJERA

**Identifikimi dhe evidenca e personave të cilët realizojnë kontakte**

**Neni 7**

Krahas kontakteve të realizuara me qëllim lobimi, personat që realizojnë kontakte në Kuvend duhet të identifikohen dhe për të njëjtët mbahet evidencë, sipas Rregullores për Rendin e Brendshëm në Kuvend.

## IV. TRANSAPRENCA E PROCESEVE

**Përgatitja, miratimi dhe ndryshimi i ligjeve, akte nënligjore ose akte të tjera të përgjithshme**

**Neni 8**

(1) Përgatitjen e propozim-ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme dhe të amendamenteve të propozim-ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme e kryen Shërbimi i Kuvendit me kërkesë të deputetit/deputetëve ose në bazë të diskutimit të mbledhjeve të trupave punues. Përgatitja dhe shqyrtimi i propozim-ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme bëhet në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.

(2) Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit kujdeset në mënyrë transparente t'i publikojë të dhënat për proceset nga paragrafi (1) i këtij neni.

**Publikimi i njoftimeve për takimet dhe mbledhjet zyrtare të realizuara**

**Neni 9**

(1) Kuvendi në faqen zyrtare www.sobranie.mk rregullisht publikon njoftime për të gjitha takimet dhe mbledhjet zyrtare të realizuara, pa marrë parasysh nëse takimi/mbledhja është për qëllim lobimi apo për qëllim tjetër.

(2) Nëpunësit e Kuvendit nga Seksioni për informim të publikut njoftimet i publikojnë menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh pune pas mbajtjes së takimit zyrtar, përkatësisht mbledhjes.

(3) Në njoftimet për takimet dhe mbledhjet

(3) Во соопштенијата за остварените официјални средби и состаноци, зависно од целта на средбата/состанокот, се содржани следните податоци:

А) ОСТВАРЕНИ СРЕДБИ/СОСТАНОЦИ СО ЦЕЛ ЛОБИРАЊЕ

1. датум, време, начин и место на остварување на средбата/состанокот;
2. да се наведе дека средбата/состанокот е со цел лобирање;
3. име, презиме и функција на лицето/лицата кај кои се лобира, други претставници кои учествувале на средбата/состанокот;
4. име и презиме на лобистот/назив на лоби организацијата – кои учествувале на средбата/состанокот;
5. податоци за нарачателот на лобирањето;
6. краток опис на предметот на лобирање за кој се дискутирало на средбата/состанокот;
7. краток опис на документацијата споделена во врска со предметот на лобирање и
8. фотографии/видео запис од средбата/состанокот (по можност).

Б) СРЕДБИ И СОСТАНОЦИ ОСТВАРЕНИ СО ДРУГА ЦЕЛ

1. датум, време, начин и место на остварување на средбата/состанок;
2. цел на средбата/состанокот;
3. име, презиме и функција на претставникот/ците кои учествувале на средбата/состанокот;
4. име, презиме/назив на правно лице/ на учесниците со кои е одржана средбата/состанокот и во кое својство учествувале;
5. краток опис на предметот на дискусија на средбата/состанокот;
6. краток опис на споделената документација (доколку постои) и
7. фотографии/видео запис од средбата/состанокот (по можност).

(4) Објавените соопштенија за остварените официјални средби/состаноци ќе

zyrtare të realizuara, varësisht nga qëllimi i takimit/mbledhjes, përmbahen këto të dhëna:

A) TAKIME/MBLEDHJE TË REALIZUARA ME QËLLIM TË LOBIMIT

1. data, ora, mënyra dhe vendi i realizimit të takimit/mbledhjes;
2. të theksohet se takimi/mbledhja është për qëllime lobimi;
3. emri, mbiemri dhe funksioni i personit/personave tek të cilët lobohet, përfaqësuesve tjerë që kanë marrë pjesë në takim/mbledhje;
4. emri dhe mbiemri i lobistit/emri i organizatës lobuese - të cilët kanë marrë pjesë në takim/mbledhje;
5. të dhëna për porositësin e lobimit;
6. përshkrim të shkurtër të temës së lobimit për të cilën është diskutuar në takimi/mbledhje;
7. përshkrim i shkurtër i dokumentacionit të ndarë në lidhje me lëndën e lobimit dhe
8. fotografi/video incizim i takimit/mbledhjes (sipas mundësisë).

B) TAKIME DHE MBLEDHJE TË REALIZUARA ME QËLLIM TJETËR

1. data, ora, mënyra dhe vendi i realizimit të takimit/mbledhjes;
2. qëllimi i takimit/mbledhjes;
3. emri, mbiemri dhe funksioni i përfaqësuesit/ve të cilët kanë marrë pjesë në takim/mbledhje;
4. emri, mbiemri/emërtimi i personit juridik/ i pjesëmarrësve me të cilët është mbajtur takimi/mbledhja dhe në çfarë cilësie kanë marrë pjesë;
5. përshkrim i shkurtër i lëndës së diskutimit në takim/mbledhje;
6. përshkrim i shkurtër i dokumentacionit të ndarë (nëse ekziston) dhe
7. fotografi/video incizim i takimit/mbledhjes (sipas mundësisë).

(4) Njoftimet e publikuara për takimet/mbledhjet e mbajtura zyrtare do të jenë të disponueshme në ueb faqen zyrtare të Kuvendit për periudhë prej pesë vitesh nga dita e publikimit.

бидат достапни на официјалната веб-страница па Собранието во период од пет години од денот на објавувањето.

## V. ЗАВРШНА ОДРЕДБА

**Член 10**

Овој правилник влегува во сила со денот на неговото донесување, а ќе се објави на веб - страницата на Собранието www.sobranie.mk.

## V.DISPOZITË PËRFUNDIMTARE

**Neni 10**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj, ndërkaq do të publikohet në ueb - faqen e Kuvendit www.sobranie.mk.

Број/Numër
01-560/1
25.01
2024 година/viti

Скопје/Shkup

**Претседател**
**на Собранието на Република**
**Северна македонија/Kryetari i Kuvendit të**
**Republikës së Maqedonisë së Veriut**
mr. Talat Xhaferi, c.p./d.v.

Образец 1

## ОБРАЗЕЦ ЗА ЕВИДЕНЦИЈА НА КОНТАКТИ СО ЦЕЛ ЛОБИРАЊЕ

1. **Име и презиме на физичкото лице/назив на правното лице кое остварило контакт со цел лобирање во Собранието (нарачател на лобирање)**

-
-

2. **Контакт информации за лобистот /претставникот на лоби организацијата**

Адреса:

Телефон:

Е-адреса:

Веб –страница:

3. **Име, презиме и функција на лицето /лицата кај кои се лобира во Собранието**

-
-
-

4. **Датум, место и начин на остварување на контакт**

5. **Предмет на лобирање**

6. **Други релевантни податоци**

Formulari 1

| FORMULAR PËR EVIDENCË TË KONTAKTEVE ME QËLLIM TË LOBIMIT |
|---|
| 1. Emri dhe mbiemri i personit fizik/emërtimi i personit juridik që ka realizuar kontakt me qëllim të lobimit në Kuvend (porositës i lobimit)<br>-<br>- |
| 2. Informacione për kontakt për lobistin /përfaqësuesin e organizatës së lobit |
| Adresa: |
| Telefoni: |
| E-adresa: |
| Ueb –faqja: |
| 3. Emri, mbiemri dhe funksioni i personit/personave te të cilët lobohet në Kuvend<br>-<br>-<br>- |
| 4. Data, vendi dhe mënyra e realizimit të kontaktit |
| 5. Lënda e lobimit |
| 6. Të dhëna tjera relevante |